



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 4682 Prot.

Elbasan, më 17.8.2026

VENDIM

Nr. 674 datë 17.8.2026

“Për përcaktimin e detyrave, përgjegjësi dhe kompetencave”

Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të aktivitetit administrativ të administratës së Bashkisë dhe rritjen e efikasitetit të saj, bashkërendimin e aktivitetit të strukturave në realizimin e funksioneve dhe shërbimeve publike, bazuar në nenet 8, 9, 59 e 64 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) dhe në nenet 28 e 29 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i R.Sh.” (i ndryshuar);

VENDOSA:

- 1) Zv/kryetarja e Bashkisë, **zj. KLAUDIA KRASNIKA**, është përgjegjëse për drejtimin, organizimin e punës, ndarjen e detyrave, kontrollin dhe monitorimin e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse (me përjashtim të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës), Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike si dhe strukturave vartëse të tyre.
- 2) Në funksion të realizimit të përgjegjësi si mësipër, zv/kryetares zj. Klaudia Krasnika, i delegohen kompetencat si mëposhtë:
 - *Kontrollon dhe nënshkruan të gjithë korespondencën e krijuar dhe aktet e nevojshme administrative, në funksion të realizimit të përgjegjësi të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi;*
 - *Kur, për realizimin e funksioneve të përcaktuara në këtë vendim, është e nevojshme lidhja e kontratave apo marrëveshjeve, në të cilat Bashkia është palë, ato mund të nënshkruhen nga zv/kryetari me autorizim të posaçëm të Kryetarit të Bashkisë;*
 - *Verifikon dhe bën shpërndarjen e korespondencës së ardhur në Bashki nga institucionet apo entet e ndryshme, duke ia adresuar strukturave përkatëse;*
 - *Nënshkruan planimetritë e shpronësimeve, që bëhen për interes publik, hartuar nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Strehimit;*
 - *Kontrollon, miraton e nënshkruan materialet që paraqiten në Këshill Bashkiak, si*

relacione, projektvendime etj., që kanë lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë të përcaktuara në këtë vendim si dhe merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të këtij këshilli;

- *Ushtron të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e Bashkisë si “Autoritet Kontraktor” në fushën e prokurimeve publike, përfshirë nxjerrjen e urdhërave të prokurimit dhe nënshkrimin e kontratave për të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, përfshirë dhe procedurat e “blerjeve të vogla”;*
 - *Nënshkruan dokumentacionin e vërtetuar me origjinalin, të dalë nga arkiva e Bashkisë;*
- 3) Aktet dhe shkresat zyrtare, të dala në zbatim të kompetencave të sipërcituara, do të jenë njëloj të detyrueshme për Administratën e Bashkisë dhe njësitë vartëse të saj.
 - 4) Ushtrimi i këtyre kompetencave do të bëhet nga data 17.8.2026 deri në një urdhër të dytë.
 - 5) Zv/kryetare, zj. Klaudia Krasnika, nuk mund të nëndelegojë këto kompetenca tek punonjës apo struktura të tjera të Bashkisë.
 - 6) Zv/kryetare, zj. Klaudia Krasnika, do të raportojë periodikisht, por jo më rrallë se një herë në muaj, për realizimin e detyrave të përcaktuara në këtë vendim.
 - 7) Vendimi nr. 486 datë 07.7.2025 i Kryetarit të Bashkisë dhe të gjitha aktet e tjera të delegimit të kompetencave për zv/kryetaren, zj. Klaudia Krasnika, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.
 - 8) Ngarkohen zv/kryetare, zj. Klaudia Krasnika, dhe Administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi si dhe Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Medias, me publikimin e tij.
 - 9) Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Bashkisë.

KRYETARI
Gledian Llatja

